

**Protokoll ndërmjet Qeverisë Federale të Austrisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për zbatimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë Federale të Austrisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës
Mbi ripranimin dhe transportimin transit të personave
(Marrëveshje mbi Ripranim)**

Qeveria Federale e Austrisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës sipas nenit 11 të Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë Federale të Austrisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës mbi ripranimin dhe transportimin transit të personave (të quajtur në vazhdim „Marrëveshje mbi Ripranim“) të datës 30.09.2010, u morën vesh si vijon:

Neni 1

Autoritetet kompetente dhe mjetet e komunikimit

1. Autoritetet kompetente për zbatimin e Marrëveshjes së Ripranimit nga ana austriake janë:

- a. Për parashtrimin dhe trajtimin e kërkesave për ripranim dhe transportim transit sipas neneve 1, 3 dhe 8 të Marrëveshjes së Ripranimit:

Ministria Federale për Punë të Brendshme
Sektori II/3

- b. Për lëshimin e dokumenteve të nevojshme të udhëtimit sipas neneve 2 dhe 5 të Marrëveshjes së Ripranimit:

Ambasada e Republikës së Austrisë në Prishtinë

2. Autoritetet kompetente për zbatimin e Marrëveshjes së Ripranimit nga ana kosovare janë:

- a. Për parashtrimin dhe trajtimin e kërkesave për ripranim dhe transportim transit sipas neneve 1, 3 dhe 8 të Marrëveshjes së Ripranimit:

Ministria për Punë të Brendshme
Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion

- b. Për lëshimin e dokumenteve të nevojshme të udhëtimit sipas neneve 2 dhe 5 të Marrëveshjes së Ripranimit:

Ambasada e Republikës së Kosovës në Vjenë

3. Kërkesa për ripranim sipas nenit 2 ose nenit 5 të Marrëveshjes së Ripranimit do të dërgohet me e-mail, përkatësisht përmes faksit në raste të veçanta. Konfirmimi i dërgimit vlen si dëshmi për pranimin e kërkesës dhe me të fillon afati.

4. Palët kontraktuese i shkëmbejnë njëra-tjetrës të dhënat kontaktuese në lidhje me autoritetet e përmendura në këtë nen përmes rrugëve diplomatike.

Neni 2

Pikat e kalimit të kufirit

1. Aeroportet që do të përdoren për rikthimin dhe transportimin transit të personave me qëndrim të paligjshëm janë:

- Në territorin austriak:

Aeroporti Ndërkombëtar i Vjenës
Wien-Schwechat
Komanda e Policisë së Qytetit Schwechat
Inspeksioni i Policisë Kufitare

- Në territorin kosovar:

Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës
Sllatinë

2. Në raste të veçanta, sipas nevojës, mund të përdoren edhe pika të tjera për kalimin e kufirit për rikthimin dhe transportimin tranzit të personave, përveç pikave të përmendura të kalimit të kufirit.

3. Palët kontraktuese i shkëmbejnë njëra-tjetrës të dhënat kontaktuese në lidhje me autoritetet e përmendura në këtë nen përmes rrugëve diplomatike.

Neni 3

Modalitetet e dorëzimit dhe lloji i transportimit

1. Me miratimin e palës kontraktuese së cilës i është kërkuar ripranimi ose pas skadimit të pafrytshëm të afatit 30 ditor në rast të pranimit të shtetasve të vetë (neni 2, paragrafi 4, të Marrëveshjes mbi Ripranimin), përkatësisht afatit 45 ditor në rast të pranimit të shtetasve të shteteve të treta ose të personave pa shtetësi (neni 5, paragrafi 3, i Marrëveshjes mbi Ripranimin), pala kontraktuese kërkuuese i dërgon palës kontraktuese së kërkuar një njoftim me shkrim që duhet të përmbajë të dhënat në vijim:

- llojin e rikthimit (rrugë ajrore ose tokësore)
- datën e dorëzimit
- orën e dorëzimit
- vendin e dorëzimit (pikën e kalimit të kufirit)
- gjendjen shëndetësore të personit që do të dorëzohet si dhe
- informacionin nëse rikthimi do të bëhet me personel shoqërues (në këtë rast të dhënat e personave shoqërues dhe në rast nevojë masat e sigurisë që duhet të merren në vendin e mbërritjes).

2. Në rast të zgjatjes së afatit për shkak të pengesave juridike ose faktike, pala kontraktuese kërkuuese informon menjëherë palën kontraktuese të kërkuar mbi largimin e pengesave dhe për vendin si dhe datën dhe orën e dorëzimit të synuar.

Neni 4

Modalitetet e rikthimit të shoqëruar dhe transportimi transit

1. Gjatë rikthimit të shoqëruar ose transportimit transit, personeli shoqërues i palës kontraktuese kërkuese duhet të jetë në gjendje të dëshmojë në çdo moment identitetin e tij si dhe autorizimin e tij dhe llojin e detyrës së tij duke paraqitur miratimin e lëshuar nga pala kontraktuese e kërkuar në lidhje me rikthimin ose transportimin transit.
2. Mbikëqyrja gjatë rikthimit ose transportimit transit bëhet nga pala kontraktuese kërkuese, në rast nevoje me përkrahjen e palës kontraktuese së kërkuar.
3. Kompetencat e personelit shoqërues gjatë kryerjes së rikthimit ose të transportimit transit kufizohen në vetëmbrojtje dhe ndihmë emergjente. Përveç kësaj, në mungesë të personelit të palës së kërkuar ose në përkrahjen e tij, personeli shoqërues mund të reagojë në një mënyrë të arsyeshme dhe të përshtatshme ndaj një rreziku të rëndë evident për të penguar që personi të arratiset, të vetëplagoset, të plagosë një të tretë ose të shkaktojë dëme materiale.
4. Personeli shoqërues duhet të respektojë legjislacionin e palës së kërkuar.
5. Në rastin e rikthimit të shoqëruar, shoqërimi nuk kufizohet në persona të autorizuar nga shteti kërkues, nëse fjala është për persona të autorizuar nga Republika e Kosovës, një shtet anëtar i Bashkimit Evropian ose Zvicra.

Neni 5

Shpenzimet

1. Në rast se janë krijuar shpenzime të pala kontraktuese, e cila nuk është e detyruar për mbajtjen e tyre sipas nenit 9 të Marrëveshjes mbi Ripranimin, këto shpenzime duhet të paguhen nga pala e detyruar kontraktuese përmes transaksionit bankar brenda 30 (në fjalë: tridhjetë) ditëve pas marrjes së faturës.
2. Palët kontraktuese shkëmbejnë informatat bankare përmes rrugëve diplomatike.

Neni 6

Gjuha

Komunikimi midis palëve për zbatimin e Marrëveshjes mbi Ripranimin do të bëhet në gjuhën shqipe, serbe, gjermane dhe angleze.

Neni 7

Bisedimet e ekspertëve

1. Palët kontraktuese bien dakord të krijojnë një komision ekspertësh dypalësh nën drejtimin e autoritetit kompetent përkatës sipas nenit 1.
2. Bisedimet mbi zbatimin e Marrëveshjes mbi Ripranimin dhe aplikimin e protokollit të zbatimit për Marrëveshjen mbi Ripranimin do të organizohen sipas nevojës.

Neni 8

Dispozitat përfundimtare

1. Ky protokoll zbatimi hyn në fuqi njëkohësisht me Marrëveshjen e Ripranimit.
2. Secila palë kontraktuese mund të propozojë ndryshime të këtij protokollit zbatimi. Protokollit i zbatimit do të ndryshohet ose do të plotësohet me pëlqim reciprok me shkrim nëpërmjet një protokollit ndryshues. Protokollit ndryshues hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
3. Ky protokoll zbatimi nuk do të zbatohet në rast të pezullimit të Marrëveshjes mbi Ripranimin.
4. Në rast të shfuqizimit të Marrëveshjes mbi Ripranimin do të shfuqizohet njëkohësisht edhe ky protokoll zbatimi.

E bërë në Vjenë më 30.09.2010 në dy origjinal, secili në gjuhën gjermane, shqipe dhe serbe, secili version me fuqi të njëjtë detyruese.

Për Qeverinë Federale
të Austrisë

Maria Fekter m.p.

Për Qeverinë e
Republikës së Kosovës

Bajram Rexhepi m.p.